



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavuke

A nr. 246/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren, paraqitur kundër Bashkimi Demokratik (BD), në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në objektin publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, kështu që subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD), i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 400 (katërqind ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 11.10.2013, nga subjektit politik PDK, me të cilën pretendohet se anëtarë të subjektit politik BD, në Prizren kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune të Prizrenit, në objektin publik përkatësisht në objektin e AKP-së në Prizren në rrugën “Bozhdarhane” me të cilin veprim kanë bërë shkeljen nenit 33 pika b tw LZP-sw.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi subjektin politik BD në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr. 246/2, PZAP-mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik BD, në të cilën ka sqaruar se është e vërtetë se posteri i tyre gjendet në atë ndërtesë siç ka pretenduar subjektit politik PDK, mirëpo ky objekt sipas tyre është jashtë funksionit dhe se në atë objekt ka të vendosura edhe dhjetëra poster të subjekteve të tjera politike duke përfshirë edhe atë të PDK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar komune nga radhët e subjektit politik BD, është e

vendosur në objektin publik, e që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike, në apo mbi rrugët publike, ne shenjat publike te trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.
- Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar komune nga radhët e BD-së, është i vendosur në objektin publik të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik BD merr pjesë për herë të parë si subjekti politik për Zgjedhjet Lokale dhe se ky subjekti politik merr pjesë në garë për kryetar komune vetëm në Komunën e Prizrenit .

PZAP-i, duke marr parasysh tw gjitha arsyet e sipwrshenuara konstatoi se subjektit politik BD ka shkelur nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, sepse nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri nga radhët e BD-së është i vendosur në objektin publik, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa në Prishtinë

Anr. 246/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



#### *Udhëzim Juridik:*

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.